



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE**  
**KËSHILLI DREJTUES**

Nr. Prot. \_\_\_\_\_

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2024

**VENDIM**

**Nr.25, datë 31.10.2024**

**PËR**  
**MIRATIMIN E RREGULLORES**  
**“PËR REGJISTRIN E SUBJEKTEVE ANËTARE**  
**TË SKEMËS SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE**  
**DHE REGJISTRIN E SUBJEKTEVE TË PËRJASHTUARA**  
**NGA SKEMA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE”**

Në bazë dhe në zbatim të nenit 24, të nenit 52 pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 7, pika 4 dhe të nenit 8, pika 2, shkronja “k” të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 18, pika 2 të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë rregulloren “Për regjistrin e subjekteve anëtare të skemës së sigurimit të depozitave dhe regjistrin e subjekteve të përjashtuara nga skema e sigurimit të depozitave”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.





2. Ngarkohen Sektori i Sigurimit dhe Kompensimit të Depozitave dhe Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Shqipe Malaj

Sekretare

Donald Duraj

Kryetar

